



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
DIVIZIONI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2383/Prot  
1

Tiranë më 04.03.2026

**Lënda:** Njoftim për në faqen zyrtare të AKBN-së

**DREJTORIT EKZEKUTIV**

**Genci Tërpo**

OK TB  
11/04/26

Bazuar në nenin 23, kreut IV i Rregullores së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për mënyrën e marrjes në punë për vende të lira në organikën e AKBN-së, ju bëjmë me dije se duhet të publikojmë në faqen zyrtare [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al) të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, njoftim për vendin vakant i cili do të bëhet në bazë të pozicionit të punës dhe arsimit përkatës.

**Pozicion vakant:**

**Një (1) pozicion vakant– Drejtor i Divizionit Teknik:**

**Kriteret:**

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në degën Juridik;
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vite eksperiencë si drejtues;
- Të ketë mbi 15 (pesëmbëdhjetë) vite eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri shumë të mira për të punuar me programet bazë kompjuterike, të Office Word, Excel, Power Point;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, organizimt të punës në grup.

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tirane, Shqipëri, [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)  
AKBNTel : 355 (0) 4 225 7117; Fax 355 (0) 4 225 7382 55 (0) 4 225 7382

**Detyrat kryesore që do të kryejë Drejtori i Divizionit Teknik janë:**

- Organizon dhe drejton veprimtarinë e Drejtorive në varësi dhe përgjigjet para Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, për zbatimin e detyrave të programuara, që ka divizioni;
- Informon Drejtorin Ekzekutiv periodikisht dhe sa herë që i kërkohet mbi realizimin e detyrave të divizionit
- Bashkërendon dhe mbikëqyr punën e drejtorive të varësisë, lidhur me zbatimin dhe realizimin e programit të punës, që ata kanë;
- Në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive merr në shqyrtim dhe miraton paraprakisht programin vjetor të punës së Divizionit dhe plan-buxhetin;
- Zhvillon mbledhje me Personelin në varësi dhe evidenton e jep zgjidhje problematikave të ndryshme;
- Kërkon hartimin e planeve të punës së drejtorive në varësi dhe ndjek realizimin e tyre;
- Informon Drejtorin Ekzekutiv periodikisht dhe sa herë që i kërkohet mbi realizimin e detyrave të divizionit;
- Përfaqëson divizionin për zgjidhjen e problematikave brenda institucionit;
- Jep miratimin për korrespondencën që del nga divizioni teknik;
- Me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv, përfaqëson AKBN për konsultimin, propozimin dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të energjitikës;
- Me autorizim të Drejtorit Ekzekutiv organizon dhe/ose merr pjesë në takime pune, me përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore apo/dhe subjekte, për çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së Divizionit;
- Ndjek zbatimin e politikave të qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe energjitike;
- Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së divizionit, opinionin teknik për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjitike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore apo private, vendase ose të huaja. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;

- Ndjek promovimin e burimeve minerare, hidrokarbure dhe burimet e rinovueshme të energjisë në zbatim të politikave të qeverisë;
- Nëpërmjet punonjësve të Drejtorisë Hidrokarbure asiston Drejtorinë e Monitorimit gjatë procesit të auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure;
- Merr pjesë në negociatat për marrëveshjet hidrokarbure, lejet minerare si dhe kontratat koncesionare në fushën e energjitikës sipas nevojave të strukturave përkatëse të qeverisë;
- Ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure, lejeve minerare si dhe kontratave koncesionare në fushën e energjitikës si dhe ndjek zbatimin e planeve të zhvillimit të tyre;
- Menaxhon burimet njerëzore të divizionit dhe ndan detyrat ndërmjet drejtorive të divizionit;
- Monitoron punën e drejtorive të divizionit;
- Angazhohet dhe kryen detyra të ngarkuara direkt nga Drejtori Ekzekutiv;
- Kryen detyra të ndryshme që dalin gjatë vitit në funksion të nevojave të Divizionit dhe të AKBN-së, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Drejtori Ekzekutiv.

**Dokumentet që duhet të paraqesin të interesuarit janë:**

- Curriculum Vitae;
- Çertifikata e gjendjes familjare;
- Diploma e shkollës së lartë, lista e notave (të njësuar me origjinalin);
- Çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve, në rast se ka;
- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja, në rast se ka;
- Dokumenti i laurimit me gradë shkencore, në rast se ka;
- Fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit.
- Librezë pune;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- 3 foto dokumentash;
- Dëshmi penaliteti;
- Raport mjekësor.

Afati i dorëzimit të dokumenteve është dy ditë pune nga shpallja e njoftimit në faqen zyrtare të AKBN-së. Dokumentet duhen dorëzuar pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Sektorin e Arkivë Protokollit .

**DREJTOR I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Redi Vasili**



---

*Adresa:* Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tirane, Shqipëri, [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)  
*AKBN Tel :* 355 (0) 4 225 7117; Fax 355 (0) 4 225 7382 55 (0) 4 225 7382